

Çfarë po Ndodh në Shkollat Publike të NYC

Shiko këtë dokument në shqip

عرض هذه الوثيقة باللغة العربية

এই নথিটি বাংলা ভাষায় দেখুন

查看本文件的简体中文版本

查看本文件的繁體字中文版本

Consultez ce document en français

Gade dokiman sa a an Kreyòl ayisyen

이 문서를 한국어로 보십시오

Документ на русском языке

Consulte este documento en español

Переглянути цей документ українською мовою

اس دستاویز کو اردو میں ملاحظہ کریں

Ushbu hujjatni ichida ko'ring O'zbek

schools.nyc.gov/MessagesForFamilies

Shkurt 2026

Ky përditësim për familjet ofron informacion të rëndësishëm lidhur me pranimin në programet pre-k dhe 3-K të Shkollave Publike të Qytetit të Nju-Jorkut (New York City Public Schools, NYCPS) për vjeshtën 2026; Anketën e Shkollave të NYC-së për vitin 2026, si dhe aktivitetet e muajit shkurt: Dita e Veprimt për Klimën dhe Java e Respektit për të Gjithë.

Përmbajtja

- **Data të Rëndësishme të Pranimeve**
- **Angketa e Shkollave të NYC-së për Vitin 2026**
- **Aktivitetet dhe Përkujtuesit e Muajit Shkurt**

Data të Rëndësishme të Pranimeve për Vjeshtën e Vitit 2026

Mos harroni të dorëzoni aplikimin për 3-K dhe/ose pre-k në [MySchools.nyc](https://myschools.nyc.gov) deri të **premtën e 23 shkurtit 2026!** Nëse fëmija juaj ka lindur në vitin 2023, mund të ndjekë 3-K këtë vjeshtë. Nëse fëmija juaj ka lindur në vitin 2022, mund të ndjekë pre-k këtë vjeshtë.

Më shumë informacion mbi arsimin 3-K dhe pre-k falas, mënyrën se si të gjeni një program dhe si të aplikoni, mund të gjeni në schools.nyc.gov/3K ose schools.nyc.gov/PreK. Aktivitetet virtuale informuese mbi pranimet, ku mund të merrni pjesë, i gjeni në schools.nyc.gov/ESEvents.

Angketa e Shkollave të NYC-së për Vitin 2026

Duke filluar nga **9 shkurti 2026**, NYCPS do të zhvillojë **Anketën Vjetore të Shkollave të NYC-së**. Familjet dhe nxënësit e klasave 6-12 të NYCPS-së mund të japin opinione të drejtpërdrejta mbi përvojat e tyre në shkollat publike. Përgjigjet tuaja konfidenciale e ndihmojnë shkollën të kuptojë më mirë nevojat e nxënësve, mësuesve dhe komunitetit, si dhe të përmirësojë mjediset e të nxënësve, kurrikulat, shërbimet mbështetëse dhe shumë të tjera.

Për të plotësuar anketën, vizitoni nycschoolssurvey.org ose hyni në llogarinë tuaj në Shkollat Publike të Nju-Jorkut (New York City Schools Account) (**NYCSA**) në [schoolsaccount.nyc](https://schoolsaccount.nyc.gov) duke filluar nga data **9 shkurt**. Do të merrni gjithashtu një kopje të printuar të anketës me udhëzime se si ta plotësoni në letër ose online. Anketa e vitit 2026 do të mbyllet **më 1 prill 2026**. Mësoni më shumë në nycschoolssurvey.org.

Aktivitetet dhe Përkujtuesit e Muajit Shkurt

- Dita e Veprimit për Klimën “Energjia” është **më 4 shkurt!** Gjeni aktivitete argëtuese në schools.nyc.gov/ClimateAction.
- Java e Respektit për të Gjithë (RFA) është **më 9-13 shkurt 2026!** Vizitoni schools.nyc.gov/RespectForAll për ide kreative aktivitete që theksojnë vlerësimin dhe respektin për njëri-tjetrin, pavarësisht besimeve apo prejardhjeve të ndryshme.
- Në datat **16-20 shkurt 2026** shkollat do të jenë të mbyllura për pushimet mesit të dimrit.